



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:051690

C. nr. 416/2021

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05517141

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.V. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. F.S. me adresë: Gjilan, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi në Prizren, me objekt kontesti kompensimin e pagave jubilarë, vlera e kontestit 564.83 (pesëqind e gjashtëdhjetë e katër euro e tetëdhjetë e tre cent), jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 28 Mars 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit M.v. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të: *“Detyrohet e paditura Sh.S.K.U.K. – Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi në Prizren, që paditësit, në emër të shpërblimit jubilar të i paguajë (kompensojë) një (1) paga mujore neto, në shumën prej 564.83 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm”*, si e pa bazuar.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi M.V. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij pranë kësaj gjykate, me datën 19 Mars 2021, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e pagave jubilarë, vlera e kontestit 564.83 (pesëqind e gjashtëdhjetë e katër euro e tetëdhjetë e tre cent).

Në referatin e padisë i autorizuari i paditësit ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në vendin e punës infermier në Qendrën e Shëndetit mendor dhe Shtëpitë për Integrim në Bashkësi në Prizren. Duke marrë për bazë dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale, konkretisht, nenit 17 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, paditësi I është drejtuar të paditurës si punëdhënës me kërkesë që t’ja paguaj shpërblimin jubilar për punë mbi 10 vite. E paditura përkundër faktit se e ka pranuar kërkesën verbale të paditësit, përveç premtimeve se këtë pagesë do ti paguaj pas rishikimit të buxhetit, e njëjta deri më tani asnjëherë nuk i kanë paguar. Duke shtuar se kërkesa e paditësit mbështetet në Kontratën Kolektive Sektoriale në nenin 17 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 për shpërblim jubilar në vlerë të një page mujore të tij 564.83 pasi që vlera e një page mujore e paditësit është 564.83 euro, ku

njëherit i propozon gjykatës që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro, taksën për padi 20.00 euro, gjithsej në shumë të përgjithshme prej 124.00 euro.

E paditura nuk ka parashtruar përgjigje në padi përkundër faktit se e njëjta vërejtjen për parashtrimin e përgjigjes në padi e ka pranuar më datë 15.11.2021.

Me vlerësimin e gjithanshëm të të gjitha provave të administruara, fakteve të vërtetuara, veçmas secilën si dhe në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha atë së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar.

Nga vërtetimi me nr. amz. 22 të datës 04.03.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi M.V. – Infermier është në marrëdhënie punë në kohë të pa caktuar pranë Qendrës për Shëndet Mendor dhe Shtëpisë për Integrim në Bashkësi në Prizren, nga data 15.10.2003, ka gjithsej 17 vite, 4 muaj e 20 ditë përvojë pune.

Nga kontrata e punës me numër të amzës 22, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka të themeluar marrëdhënien e punës me punëdhënësin Qendrës për Shëndet Mendor dhe Shtëpisë për Integrim në Bashkësi në Prizren.

Në bazë të listës së pagave, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi realizon pagën bazë në shumë prej 425.00 euro.

Nga vërtetimi me nr.amz. 22 të datës 04.03.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi M.V. është në marrëdhënie punë Qendrës për Shëndet Mendor dhe Shtëpisë për Integrim në Bashkësi në Prizren, nga data 15.10.2003, dhe ka gjithsej 17 vite, 4 muaj e 20 ditë përvojë pune, kurse paga e fundit bazë është 564.83 euro.

Me nenin 4 par.2 të Ligjit të Punës 03/L-212, i cili është në fuqi parashihet se: *“Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”*. Po ashtu me nenin 90 të këtij ligji parashihet se *“1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës, 2.3. nivel të ndërmarrjes; 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës; 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet; 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive; 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”*.

Nga provat e administruara dhe të cekura më lartë, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit duhet të refuzohet si e pabazuar lidhur me kompensimin e një page jubilarë për 10 vite të përvojës në punë, në vlerë të një pagave mujore të tij t'ia kompensoj dhe atë shumën prej 564.83 euro dhe atë duke u bazuar në vetë kërkesën e palës paditëse, pasi që i njëjta ka kërkuar që të bëhet kompensimi i një page jubilarë, në kuptim të nenit 17 para. 3 nënparagrafi 3.1 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë në Kosovë të datës 11.06.2018. Duke analizuar nenin në fjalë, shihet se kërkesa e palës paditëse është për shpërblimin jubilar për 10 vite të përvojës së punës. Nga vërtetimi mbi përvojën e punës të lëshuar nga e paditura me datë 04.03.2021, vërtetohet fakti se paditësi ka përvojë pune prej 17 vite 4 muaj e 20 ditë. Paditësi vitin jubilar 10 vjet të përvojës së punës e ka arritur në vitin 2013. Andaj gjykata duke marrë për bazë Mendimin Juridik për shpërblimin jubilar, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të datës 27.02.2023, erdhi në përfundim se paditësi kërkesën e tij për kompensimin e pagës jubilarë e ka mbështetur në Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë në Kosovë të datës 11.06.2018, e cila kontratë në momentin e arritjes 10 viteve të përvojës së punës nga ana e paditëses nuk ka qenë në fuqi, ngase i njëjta ka qenë në zbatueshmëri nga data 11.06.2018 deri më 10.06.2021. Mbi këtë bazë gjykata konstaton se Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë e datës 11.06.2018 nuk ka zbatueshmëri në këtë çështje juridiko kontestimore pasi që paditësi 10 vite përvojë pune tek e paditura i ka arritur para nënshkrimit të kësaj kontrate, gjegjësisht me datë 15.10.2013, dhe për këtë arsye kërkesëpadia e paditëses refuzohet si e pathemeltë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi, ashtu që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, konform nenit 450 të LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr. 416/2021 datë 28 Mars 2024

B. Profesional.

Gjyqtari

Ilir Sërtollaj

Atdhe Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykatë.